

**MARRËVESHJE**

**për**

**shërbimet primare të menaxhimit të mbeturinave**

Draft Version

## Përmbajtja

Akronimet.....	3
Përkufizimet.....	3
1. Hyrje.....	5
1.1 Marrëveshja.....	5
1.2 Qëllimi.....	5
2. Fushëveprimi i shërbimit.....	6
2.1 Kushtet themelore .....	6
2.2 Shërbimet që do të ofrohen.....	6
2.3 Objektivat kryesore të këtyre shërbimeve .....	6
2.4 Shërbimet shtesë .....	7
2.5 Forca madhore .....	7
3. Standardet specifike të shërbimit.....	7
3.1. Mbledhja dhe transportimi i mbeturinave.....	7
3.2. Mbulimi me shërbime .....	8
3.3. Shërbimet e transferimit.....	8
4. Resurset dhe shkathtësitë.....	9
5. Monitorimi dhe raportimi.....	10
6. Përgjegjësitë e Komunës .....	10
7. Përgjegjësitë e ofruesit të shërbimit.....	11
8. Faturimi dhe pagesa.....	13
9. Zgjidhja e pakënaqësive dhe kontesteve.....	14
10. Rishikimi i Marrëveshjes .....	15
11. Anulimi.....	15
12. Rastet e papritura.....	15
Shtojca A – Standardet e detajuara të shërbimit .....	16
Shtojca B – Lokacionet e caktuara.....	20

## Akronimet

MSh	Marrëveshja për shërbime
MMN	Menaxhimi i mbeturinave të ngurta
OSh	Ofruesi i shërbimit
PIO	Plani i Itinerarit dhe Operativ

## Përkufizimet

Përkufizimete mëposhtme janë përputhje me nenin 4 të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturinat në Kosovë.

**Marrëveshje** dokumenti nënshkruar nga një komunë dhe ofruesi i shërbimit, në të cilën parashihen autorizimet dhe specifikacionet që ofruesi i shërbimit kryejë shërbimetsiç janë përcaktuar në këtë dokument.

**Mbeturina komerciale** - mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industriale;

**Kontejner i komunitetit** kontejner më i madh për magazinimin e mbeturinave i punuar nga materiali i qëndrueshëm që mund të ngritet dhe të zbrazet mekanikisht në automjetin për mbledhje apo të bartet deri në pikën e transferit apo në deponi, të përdoren në lagjet me popullsi të dendur, në vendet e afërta të ndërtimit apo në vendet me qasje të kufizuara të automjeteve.

**Kontejner** thes plastike, najloni apo pëlhurë dhe shportë plastike apo metali e dizajnuar për të mbajtur mbeturina të ngurta me fortësi të mjaftueshme për ta ruajtur integritetin fizik të kontejnerit kur të ngritet apo për ta evituar shkapërderdhjen e mbeturinave.

**Vend i caktuar**, bazuar në ligj është vendi për shkarkim të mbeturinave të mbledhura, duke përfshirë transferimin apo objektin e përpunimit dhe largimit, sipas udhëzimeve të komunës.

**Pajisje** çdo material i shpenzueshëm, objekt, mjet dhe impiant që kërkohet dhe që është i domosdoshëm për kryerjen e kënaqshme të shërbimeve.

**Komuna** – njësi themelore e vetëqeverisjes në Republikën e Kosovës e përkufizuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.

**Mbeturina komunale** mbeturinat nga amvisëritë dhe mbeturinat nga aktivitetet tjera të cilat, për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.

**Monitorimi** akti vëzhgimit dhembajtjes së evidencave për atë vëzhgim; ose përkujdesja; përcjellja; mbajtja nën vëzhgim apo kontrollimi i zakonshëm për një qëllim të veçantë.

**Raportimi** përgatitja e raportit (eve) të standardizuara nga ofruesi i shërbimit për komunë në mënyrë të rregullt. Fushëveprimi dhe periodicitet në këtë rast jepet sipas Manualit të PAMKOS-it për Menaxhimin e Cilësisë, së bashku me monitorimin dhe/ose metodologjinë e mbajtjes së evidencave.

**Ofruesi i shërbimit** kompania që është e angazhuar në shërbimet që janë radhitur më poshtë sipas kushteve që janë paraparë në këtë dokument.

**Shërbimet** nënkuptojnë të gjitha aktivitetet e ndërmarranga OSh/operatoris sipas kësaj Marrëveshjeje.

**Vendbanimi**, sipas Ligjit Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativë të Komunave, neni 2.3, është përkufizuar si: qytetet, lagjet urbane dhe fshatrat.

**Mbeturinat** çdo substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedhë apo është i detyruar ta hedhë;

**Mbledhja e mbeturinave** ngritja manuale apo mekanike e kontejnerëve dhe vendosja apo zbrazja e tyre në automjete të mbledhjes për transportimin e mëtejshëm në vendin e caktuar të transferimit, riciklimit, trajtimit dhe/ose deponimit.

**Deponimi i mbeturinave:** Operacionet që ofrojnë zgjidhjen përfundimtare për mbeturinat që nuk mund të ripërdoren apo përpunohen pa e rrezikuar mjedisin dhe shëndetin e njeriut

**Menaxhimi i mbeturinave** – aktivitetet për evitimin dhe reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut, përfshirë mbledhjen, transportimin, trajtimin, ripërdorimin, përpunimin, riciklimin dhe deponimin përfundimtar të mbeturinave, i përcjellur nga monitorimi dhe kujdesin edhe pas kryerjes së këtyre aktivitetëve.

## 1. Hyrje

Kjo Marrëveshje për shërbime (MSH) i përmban elementet standarde, të detyrueshmedheopsionalepër tu konsideruar e vlefshme. Elementet opsionale kërkojnë veprim nga palët nënshkruese. Këto elemente janë vënë në kllapa dhe janë shënuar me ngjyrë të hirtë.

### 1.1 Marrëveshja

1. Kjo (MSH) lidhet midisKompanisë Rajonale të Mbeturinave (“ofruesi i shërbimit”/OSh) [...]dhe Komunës së [...] (“Komuna”) për ofrimin e shërbimeve primare të menaxhimit të mbeturinave në [luteni ta përkufizoni zonën gjeografike/kufijtë administrativë].
2. Komuna dëshiron ta mbajOSh-në për t’i kryer të gjitha shërbimete përshkruara në këtë Marrëveshje, ndërsaOSh-jaka dëshirëdheështë në gjendje t’i kryejë shërbimetnë përputhje me këtëMarrëveshje.
3. Kjo MShvlen për periudhën dyvjeçarenga data [luteni ta shënoni datën nënshkrimit]deri më datën[luteni ta shënonidatën e përfundimit]dhee zëvendëson çdo apo të gjitha marrëveshjet e tjera në zbatim për ofrimin e shërbimeve të përshkruara.
4. Gjatë kohëzgjatjes së kësajMarrëveshjeje, OSh-jai mbledh, largondhe transporton mbeturinat e ngurtasiç janë përkufizuar në këtë MarrëveshjedhesipasLigjit për Mbeturinat, nenit 34dheRregullores Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave Nr. [luteni ta shënoni numrin specifik nëse është e mundur].

### 1.2 Qëllimi

Qëllimi i kësajMarrëveshjejeështë që:

1. të përkufizoheshërbimetqëOSh-jaia ofron komunësdhestandardet e kërkuara për mënyrën e ofrimit, operimit dhe menaxhimit të këtyre shërbimeve.
2. të përshkruhen në detajepërgjegjësitë eKomunës,në mënyrë qëOSh-jat’i përmbushë obligimet e tijdhetë përshkruhen në hollësipërgjegjësitë eOSH-së për ofrimin e shërbimeve të kërkuara.
3. Tëpërshkruhen kërkesat për menaxhimin cilësor tëshërbimeveduke përfshirëspecifikacionet e shërbimit, monitorimin e performancës dhe raportimin.

## 2. Fushëveprimi i shërbimit

### 2.1 Kushtet themelore

1. Gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje, OSh-jai mbledh, largon dhe transporton mbeturinat e ngurta komunale që prodhohen brenda zonës së kufijve komunalë siç është përkufizuar në pikën 1.1 – 1si më lart.
2. OSh-ja e siguron tërë personelin dhe pajisjet nevojshme (siç janë përkufizuar këtu) për ta ofruar një shërbim të kënaqshëm, në një mënyrë që është në përputhje me specifikacionet e shërbimit që janë përfshirë në shtojcën A të kësaj MSh-je.
3. OSh-jai mbledh dhe transporton mbeturinat e ngurtanga të gjitha amvisëritë, subjektet afarist dhe institucionet publike (duke përfshirë shkollat, spitalet, shtëpitë e shëndetit, zyrat postare, stacionet e policisë, stacionet e zjarrfikësve dhe zyrat e organeve ligjore) që gjenden në zonën e shërbyernë vendin/vendet i/e caktuara (siç tregohet nga Komunadhesipas radhitjes në shtojcën B), brenda orarit të punës në objektin përkatës.
4. Sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje, OSh-januk do të jetë përgjegjëse për mbledhjen e mbeturinave nga pronat industriale në emër të Komunës dhe mund të angazhohet në këto aktivitete sipas marrëveshjes së drejtpërdrejtë për shërbime me vetë prodhuesit e mbeturinave si aktivitet.

### 2.2 Shërbimet që do të ofrohen

Shërbimet që do të ofrohen sipas kësaj Marrëveshjeje (sipas standardeve të detajuara të shërbimit që janë paraparë në shtojcën A) mund të përmbliken si mbledhje dhe shërbimi për transportim primar i mbeturinave.

### 2.3 Objektivat kryesore të këtyre shërbimeve

1. Te ofroje shërbime të menaxhimit të mbeturinave në një mënyrë efektive dhe të bazuar në efikasitet të kostos në përputhje me standardet mjedisore dhe operative.
2. Të mbrohen banorët dhe mjedisin nga ndotja dhe rreziqet e tjera ndaj shëndetit dhe sigurisë;
3. ;

## 2.4 Shërbimet shtesë

Çdo shërbim tjetër nga ato që janë përcaktuarnë pikën 2.2 më lartmund të kërkohet për pastrimin e hapësirave publike (p.sh. për pastrimin e parqeve dhe kopshteve, largimin e mbeturinave të vëllimshme, largimin e mbeturinave të kafshëve dhembledhjen e mbeturinave jo komunale). Aktivitetete tilla nuk janë paraparë me këtë MSh. Marrëveshjet për shërbimete tilla lidhen përmes procedurave të tenderimit dhepërcaktohen në një marrëveshje apo kontratë të ndarë.

## 2.5 Forca madhore

Nga OSh-januk do të kërkohet që t'i kryejë shërbimet që janë saktësuar në pikën2.2 si më lart nëse pengohet për ta bërë këtë nga ndonjë forcë madhore:fatkeqësitë natyrore, urdhri apo udhëzimi i qeverisë dhe autoriteteve lokale, akti i armiqve të shtetit, trazirat, grevat, shkatërrimi substancial i pajisjeve të ndonjë furnizuesi, mungesa e karburantit apo lubrifikuesve apo çdo rrethanë tjetër që Osh-ja nuk mund ta kontrollojë.

## 3. Standardet specifike të shërbimit

Shërbimet e menaxhimit të mbeturinave ofrohenë përputhje mespecifikacionet e hollësishme të shërbimit që janë paraparë në shtojcën A dhe që janë përmbledhur si vijon:

### 3.1. Mbledhja dhe transportimi i mbeturinave

1. OSh-jasiguron që të ofrohet numër i mjaftueshëm i kontejnerëve për mbledhjen e mbeturinave nga subjektet e shërbyeradhe që vëllimi dhe specifikacionet e tyre të mjaftojnë për ta vendosur në to sasinë e mbeturinave të prodhuara komunale. Numri dhe lloji i kontejnerëve duhet të llogaritet duke e përdorur një shkallë mesatare të prodhimit të mbeturinave dhe duke u bazuar në përvojën e mëparshme.
2. OSh-ja ofron shërbim të mbledhjes së mbeturinave të rregullt dhe të besueshëm, duke u siguruar që të gjitha mbeturinat e ngurtakomunale që janë vendosur në kontejnerë (apo që janë derdhur përreth tyre) të mblidhen dhe transportohen në vendet e caktuara.
3. Ky shërbim do të ofrohet duke u bazuar në Planin Itinerarit dhe Operativ (PIO-në) për çdo zonë të shërbimit. Në ditët pas festave publike mund të kërkohen shërbime shtesë.
4. Për hir të efikasitetit të punës, OSh-jae përgatit dhe dorëzon një PIO dhenë të

përfshin:

- a. Sistemin e itinerarit: Duke u bazuar në lokacionet e kontejnerëve (posaçërisht të kontejnerëve të komunitetit), siç është përcaktuar nga Komuna, në secilin vendbanim brenda zonës së shërbimit të mbledhjes së mbeturinave, OSh-jaduhet ta krijojë një sistem të itinerarit të cilin do ta ndjekin automjetet për mbledhjen e mbeturinave dhe ia dorëzojë atë Komunës për aprovim.
  - b. Xhirot e rregullta të mbledhjes dhe orari i tyre: Ofrimi i rregullt dhe orari i shërbimeve duhet të bazohen në llogaritjet, specifikacionet e secilit vendbanim dhe përvojën e mëparshme të OSh-së. Llogaritjet për secilin vendbanim duhet të bazohen në numrin e banorëve, llojet e mbeturinave të prodhuara dhe shkallët e prodhimit të mbeturinave.
  - c. Intervalet e rishikimit: PIO-ja do të rishikohet duke u bazuar në një mekanizëm drejtues në intervale periodike prej 6 muajsh apo kur të kërkohej nga Komuna.
5. Në zonat ku ka qasje të kufizuar të automjeteve, OSh-jamund të sigurojë kontejnerë të komunitetit në periferi të vendbanimit apo t'i mbledhë dhe largojë mbeturinat duke përdorur automjete të vogla me specifikacione të përshtatshme teknike. OSh-ja ofron shërbime mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave anë të automjeteve/pajisjeve në dispozicion, të përshtatshme për lëvizje në këtë zonë dhe të pajisura me një pajisje funksionale për ngritje mekanike.

### 3.2. Mbulimi me shërbime

1. Vendbanimet: OSh-ja është përgjegjëse sipas kësaj Marrëveshjeje që të ofrojë shërbime të mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave nga të gjitha vendbanimet brenda hapësirës së shërbimit, siç është përkufizuar në këtë Marrëveshje. OSh-ja është përgjegjëse për pastërtinë e hapësirës së definuar, duke përfshirë heqjen e të gjitha mbeturinave të ngurta komunale të parrezikshme.
2. Për secilin vendbanim, OSh-ja do të ofrojë shërbim të duhur të mbledhjes së mbeturinave ose duke u bazuar në kushtet lokale, ose siç është përkufizuar në PIO, duke përdorur kontejnerë të përbashkët apo përmes shërbimit derë më derë.
3. Institucionet publike: Shërbimet që do të ofrohen varen nga lloji i institucionit, lloji i mbeturinës së prodhuar, sasinë e mbeturinave të prodhuar dhe vendndodhja në raport me subjektet e tjerat shërbyerë.

### 3.3. Shërbime transferit



1. Automjetet hyrëse për mbledhjen e mbeturinave do të pranohen në pikën e transferit, do të evidentohen në mënyrë elektronike dhe do të orientohen kah pjesa e caktuar për shkarkim në kontejnerët për transferim.
2. Në kushte normale të punës, mbeturinat e deponuara në pikën e transferit largohendhe transferohen në vendin e caktuar sipas nevojës (p.sh. kurkontejneri është i mbushur plot), por jo për më gjatë se një javë nga dita e pranimit të ngarkesës me mbeturina, në mënyrë që të evitohet bezdia dhe era e keqe.
3. Pika e transferit mirëmbahet dhe pastrohet së paku një herë në muajdhembushet me kontejnerë për transferim të mbuluar me mbrojtëse gome për t'i minimizuar erërat dhe lirimimin e substancave të tjera në mjedis nga ky venddhe për ta mbajtur një mjedis pune higjienik dhe të sigurt.

#### 4. Resurset dhe shkathtësitë

1. Shërbimet e menaxhimit të mbeturinave do të ofrohen nga një ekipi trajnuar në mënyrë adekuate dhe profesional që i posedon shkathtësitë relevante për ta ndërmarrë shërbimin.
2. Në të gjitha objektet dhe vendet e caktuara për menaxhimin e mbeturinave punësohen anëtarë të trajnuar të personelit, të specializuar në detyrat përkatëse të tyre.
3. Ekipi i menaxhimit i OSh-së ndërlidhet dhe bashkërendohet me Komunën dhe është i hapur për inspektim nga përfaqësuesit e Komunës (p.sh. të zyrtarit të mbeturinave) në çdo kohë.
4. OSh-jasiguron numër adekuat të punonjësve me shkathtësinë dhe trajnimin e duhur për t'i kryer shërbimet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe për të qenë të sjellshëm përherë, për të punuar në qetësi dhe për t'iu shmangur konflikteve. Secili punonjës mban veshur rroba që janë sa më të rregullta dhe më të pastra që e lejojnë rrethanat dhe mban rroba mbrojtëse personale, siç janë jelekët me dukshmëri të lartë, dorëzat e qëndrueshme dhe çizmet e helmetat e sigurisë sipas nevojës.
5. Para datës së fillimit të kësaj Marrëveshjeje, OSh-jua ofron përfaqësuesve të Komunës një listë të detajuar në të cilën përshkruhen pajisjet (përkatësisht automjetet, kamionët për ngjeshje, etj), dhe burimet njerëzore që do të përdoren për t'i kryer shërbimet. Lista përfshin prodhuesin e automjetit, madhësinë e motorit, numrin e regjistrimit/identifikimit dhe datën e prodhimit të çdo pajisjeje që do të përdoret. Çdo pajisje përfshihet në PIO/Planin Operativ.

## 5. Monitorimidheraportimi

1. OSh-jai hartondhedorëzonraportet e kërkuarasipasManualit të PAMKOS-it për Menaxhimin e Cilësisë. Shabllonetpër raportim që duhet të përdoren për këtë qëllim do t'i sigurojë PAMKOS-i.
2. Elementet e detyrueshme që duhet të raportohen përfshijnë sasi të mbeturinave të mbledhura, automjetet e dërguara, numrin e udhëtimeve, distancën e përshkuar, numrin e punëtorëve, orët e punës, karburantin e shpenzuar.
3. Këto raporteverifikohendhe monitorohen nga Komunaduke e përdorur matricën e monitorimit të PAMKOS-it (të përshtatur lokalisht) dhenë terren përmes vizitave në terrennga njësia apo zyrtari për mbeturina brenda Komunës.
4. Intervalet emonitorimitdheraportimit për çdo element të raportuar do të caktohen sipasmetodologjisë së Manualit të PAMKOS-it për Menaxhimin e Cilësisë.

## 6. Përgjegjësitë eKomunës

1. T'i caktojë, në bashkërendim meOSh-në, lokacionet për vendosjen e kontejnerëve (sipas llojit)nëvendbanime të ndryshmedhenë afërsi të arsyeshme mesubjektet e shërbyera.
2. T'i caktojë lokacionet kuOSh-jado t'i dërgojëmbeturinat e mbledhurasijç është përmendur në shtojcën B të kësaj Marrëveshjeje.
3. T'i pastrojë mbeturinat e hedhura në mënyrë ilegale që nuk konsiderohet se janë shkaktuar për shkak të mungesave nëaktiviteteteOSh-sëdhebrenda zonës së shërbimit.Kjo mund të bëhet përmes një tenderi të hapurdhetë përfshihetnë një marrëveshje apo kontratë të ndarë.
4. Komunado t'i kontrollojë rregullisht, përmes zyrtarit të mbeturinave,dhetë përpilojë raporte për mbikëqyrjen, gjendjen e konstatuar, masat dhe veprimet që janë marrë, përkatësisht urdhëruar. Një kopje e raportit duhet t'i dorëzohet OSh-së, ndërsa masat e propozuaraduhet të diskutohen. Inspektori mban shënime për inspektimet që bëhen sipas procedurës që është përcaktuar nëdispozitat eLigjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit.
5. T'i menaxhojë sistemet për inkasim ngaamvisëritënë përputhje mepolitikën tarifore komunaledhetasigurojë pagesën mujore me kohë për shërbimete

ofruaradhetë faturuara ngaOSh-janë përputhje medispozitat e kësaj MSh-je.

6. Ta përkufizojë dhe periodikisht ta përpunojë një politikë tarifore që do të përdoret për inkasim nga OSh-japër shërbimet e ofruara.

## 7. Përgjegjësitë e ofruesit të shërbimit

1. T'i kryejë shërbimet në përputhje me këtë Marrëveshje të tërë shkathtësinë dhe kujdesin e duhur.
2. Të sigurohet që shërbimet dhe objektet, materialet dhe pajisjet që përdoren për të prodhuar apo që inkorporohen në shërbimet janë të përshtatshme për qëllimin e synuar të një cilësie dhe mjeshtrie të mirë.
3. Të sigurohet që të gjitha mbeturinat e mbledhurat të dërgohen në vendet e caktuara siç është përmendur në shprehjet B të kësaj Marrëveshjeje.
4. Të marrë veprime për tu siguruar që asnjë mbeturinë e grumbulluar të mos depozitohet ilegalisht apo pa vend duke e ndotur mjedisin dhe duke e rrezikuar shëndetin e popullatës.
5. Të sigurohet në mënyrë të arsyeshme që mbeturinat që dërgohen në vendet e caktuara të mos përmbajnë ndonjë lloj të mbeturinave të rrezikshme apo të papranueshme.
6. Të mbajë evidenca aktuale, të sakta dhe adekuate për të gjithë punonjësit angazhuar në lidhje me ofrimin e shërbimeve. Këto evidenca duhet të mbahen në lokacion të përshtatshëm dhe të përfshijnë vijueshmërinë e punonjësve në punë, duke bërë dallim midis atyre që janë të angazhuar sipunëtorë operativë dhe atyre që ushtrojnë mbikëqyrje. Evidencat janë të hapura për inspektim nga komuna kurdo që të kërkohet.
7. Të përgatitet dhe dorëzohet një PIO për aktivitetin e shërbimit, në të cilin tregohen operacionet rutinore për çdo vendbanim të shërbyer. PIO-ja është dokument zyrtar që mund të ndryshohet dhe azhurnohet në kuadër të një marrëveshjeje dhe një mekanizmi drejtues të rregullt midis Komunës dhe OSh-së. Në këtë kuptim, Komuna ose OSh-ja ia dorëzojnë një kërkesë zyrtare homologut të tyre, merren vesh për ndryshimet e pastaje azhurnojnë PIO-në.
8. Të jetë përgjegjës për herë përherë për caktimin e orarit, raportimin për progresin, parashikimin dhe kontrollimin e pavarur për ta arritur kryerjen e shpejtë dhe efikase të shërbimeve.

9. Të mbajë evidenca të sakta – sipasproceseve të standardizuara dhe siç janë përkufizuar në Manualin e PAMKOS-it për Menaxhimin e Cilësisë – për tërë punën që kryhet në ofrimin e shërbimeve. Evidencat do të jenë përherë të hapura për inspektim.
10. Të jetë përgjegjës për pagesën e të gjitha çështjeve financiare, duke përfshirë pagesat e pagave për staf, të ardhurave dhe tatimet tjera, kontributet e sigurimit kombëtar ose taksat e çfarëdo lloji që ndërlidhen me punësimin e ndonjë personi apo që burojnë nga ai punësim.
11. Ta plotësojë çdo kusht ose të gjitha kushtet e raportimit financiar dhe të sipas parimeve të kontabilitetit të përcaktuara për shoqëritë aksionare me Ligjin për Shoqëritë Tregtare të Kosovës.
12. Ta krijojë dhe mirëmbajë një linjë telefonike pa pagesë dhe publikisht të dukshme brenda OSh-së ose në bashkëpunim me Komunën, me një numër të telefonit dhe/ose adresë të postës elektronike në të cilën mund të kontaktohet në çdo kohë të ditës dhe të jetë në gjendje t'i pranojë ankesat dhe në sekretariatit e operativës/selisë së OSh-së. Ankesat do të evidentohen dhe përgjigje në to do të jepen në mënyrë të shpejtë, të njerëzishme dhe efektive. Duhet të mbahen dhe të vihen në dispozicion për inspektim evidenca me shkrim për të gjitha ankesat që janë pranuar dhe veprimet që janë marrë në lidhje me ankesat tilla. Evidencat duhet të monitorohen dhe të bëhen sipas Manualit të PAMKOS-it për Menaxhimin e Cilësisë.
13. Ta testojë rregullisht kënaqësinë e konsumatorëve me shërbimet e ofruara duke përcaktuar procedurë adekuate dhe duke e nxjerrë një raport të shkurtër për nivelin e kënaqjes së konsumatorëve.
14. Ta sigurojë mirëmbajtjen e rregullt dhe preventive të të gjitha automjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për ofrimin e shërbimeve të saktësuar në mënyrë që të ngritet në maksimum produktiviteti dhe jetëgjatësia e pajisjeve për përdorim. Të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha pajisjeve që përdoren në lidhje me ofrimin e shërbimeve në përputhje me Manualin e PAMKOS-it për Menaxhimin e Cilësisë.
15. T'i menaxhojë në mënyrë të duhur mbeturinat e ngurta përherë brenda vendeve të caktuara në kontrollin operativ të OSh-së. Mbeturinat e ngurta nuk do të hidhen në drenazhe, kanalizime, tokë të hapur, gurëthyes, lumenj, kanale, moçale apo vende të tjera të pacaktuara zyrtarisht. OSh-ja përherë i mbikëqyr punëtorët e saj dhe i inspekton aktivitetet e tyre për të siguruar që të mos ndodhë deponimi i paautorizuar i mbeturinave. Sipas mundësisë, OSh-ja do t'i paguajë tarifën hyrëse të përcaktuara zyrtarisht në pikat e caktuara të deponimit dhe transferimit të mbeturinave. OSh-

jandërmerr mirëmbajtjen preventive dhëmban furnizime të mjaftueshme me pjesë rezervë për ta siguruar funksionimin e vazhdueshëm të pajisjevedhepikës së deponimit/transferimit të mbeturinave,sipas nevojës. Në rast të prishjes apo mirëmbajtjes kryesore, OSh-jasiguron pajisje të marra me qira për ta përmbushur qëllimin e synuar.

## 8. Faturimidhepagesa

[Fshijeni, nëse është e pavlefshme:ose:]

1. Komunai faturonklientët e shërbyerpërshërbimet e menaxhimit të mbeturinave, në përputhje mepolitikën tariforetë përcaktuar nga Kuvendi Komunal.
2. OSh-jae faturon Komunën në mënyrë mujore duke u bazuar në një ndarje të hollësishme të shërbimevedhenë përputhje me orarin e dakorduar të faturimit.
3. Kur OSh-ja parashtron urdhërblerje të ndara dhe kur paraqiten variacione,urdhrin për variacion duhet ta aprovojë Komuna.
4. Shërbimet e ofruarabazohen në njëmarrëveshjekornizë për një çmim fiks përnjë periudhë dymbëdhjetëmujore. Çmimorja do të rishikohet çdo vit për ta pasqyruar çdo ndryshim në tarifata e transferimit dhe deponimit.
5. Komunai paguan faturat periodike në afat prej30ditësh pas pranimit të tyre.
6. Tarifatabazohen në peshat mesatare të mëparshme për kokë banori. Në rast të ndonjë rritjeje të konsiderueshme në prodhimin e mbeturinave, p.sh. të një rritjejepre më shumë se10%,dispozitat financiarete kësajMarrëveshjemund të rishikohen.
7. OSh-jae njoftonKomunën brenda 7 ditëve në rast të paraqitjes së ndonjë force madhore, nuk ka të drejtë në pagesë për shërbimet që nuk janë kryer për shkak tëforcës madhoredhenuk konsiderohet se e ka shkelur apo nuk e ka zbatuar këtëMarrëveshjepër arsye të një moskryerje të tillë.

[Fshijeni, nëse është e pavlefshme: ose:]

1. OSh-jai faturonklientët e shërbyerpërshërbimet e menaxhimit të mbeturinave, në përputhje mepolitikën tariforetë përcaktuar nga Kuvendi Komunal.
2. OSh-jaia ofronKomunës një regjistër të azhurnuartë faturave që janë lëshuar

dhe pagesave që janë pranuar, të ndara sipas llojeve të shërbimit.

3. OSh-jae njofton Komunën brenda 7 ditëve në rast të paraqitjes së ndonjë force madhore, nuk ka të drejtë në pagesë për shërbimet që nuk janë kryer për shkak të forcës madhore dhe nuk konsiderohet se e ka shkelur apo nuk e ka zbatuar këtë Marrëveshje për arsye të një moskryerje të tillë.

## 9. Zgjidhja e pakënaqësive dhe kontesteve

1. Qëllimi i OSh-së dhe Komunës është që të merren me çdo ankesë apo pakënaqësi lidhur me nivelin e shërbimit të ofruarose vetë MSh-në në mënyrë efektive dhe efikase, që të marrin veprime të menjëhershme korrigjuese për ta zgjidhur ankesën dhe që të marrin hapa për ta evituar paraqitjen e sërishme.
2. Kontestet që ndërliidhen me shërbimin e ofruar dhetë paguarnë kuadër të kësaj MSh-je zgjidhen, në radhë të parë, gjatë takimeve kontaktuese operative të rregullta. Çdo çështje qëka të bëjë meshërbimet e ofruara apo standardet e përshkruara në këtë MSh dhe që mbetet e pazgjidhur pasi të jetë trajtuar fillimisht duhet të shkallëzohet si vijon:
  - a. **Niveli i parë:** Nëse çështja mbetet e pazgjidhur, ankesa/t duhet t'i parashtrohen me shkrim Bordit të Drejtorëve/OSh-së përkatëse, anëtarët e të cilit do ta shqyrtojnë çështjen brenda 5 ditëve të punës. Nëse çështja është e ndërlikuar dhe nuk është e mundur që të zgjidhet plotësisht brenda këtij afati kohor, atëherë një përgjigje e përkohshme me shkrim do të jepet brenda 5 ditëve të punës dhe çështja do të zgjidhet përfundimisht brenda 10 ditëve të punës.
  - b. **Niveli i dytë:** Pas nivelit të parë të zgjidhjes së kontestit, nëse çështja nuk është zgjidhur ende, atëherë ankesa/t, së bashku me dëshmitë përkatëse, duhet t'i përcillen me shkrim Komisionit Komunal të Aksionarëve përkatës. Ankuesit do t'i jepet një shqyrtim përfundimtar dhe një përgjigje me shkrim brenda 10 ditëve të punës.
  - c. **Niveli i tretë:** Nëse asnjë zgjidhje nuk mund të arrihet midis OSh-së dhe Komunës, duhet të merret në konsideratë arbitrazhi i jashtëm (Gjykata Themelore e Prishtinës), ndërsa për çdo shpenzim përkatës do të vendosë gjykata.
3. Gjatë cilësdo fazë të zgjidhjes së pakënaqësisë apo kontestit, shërbimet që ende nuk janë ofruar në shkallën e dakorduar të standardit të përcaktuar në kuadër të këtij dokumenti mund të jenë shkas për një ndëshkim financiar që duhet të përcaktohet pas procesit të monitorimit nga Komuna. Për më tepër, çdo shpenzim që është bërë për ta korrigjuar çdo lëshim apo moszbatim të kësaj MSh-je do të kompensohet në tërësi. Deri sa të merret vendim e të qartësohet mosmarrevesha apo pakënaqësia, OSh do të vazhdojë të ofrojë

shërbimet në bazë të kësaj marrëveshjeje.

## 10. Rishikimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshjetë gjitha pjesët përbërëse të saj do të rishikohen për çdo vit.
2. Rishikimi do të përqendrohet në cilësinë e shërbimit dhe vlerën përpara që është marrë gjatë vitit të kaluar dhe në planifikimin e ardhshëm duke punuar së bashku për ta përmirësuar shërbimin sipas PIO-së të OSh-së, prokurimin dhe strategjitë për efikasitet.
3. Për çdo ndryshim/ndërrim në shërbimet e ofruara që do të ndikojë gjatë implementimit të kësaj Marrëveshjeje duhet të dakordohet nga të dyja palët.

## 11. Anulimi

1. Kjo Marrëveshje mund të anulohet me pajtimin e të dyja palëve me shkrim ose nëse cilado palë jep njoftim me shkrim për anulimin e kontratës për anulim para 4 muajve.
2. Nëse OSh-januk i ofron shërbimet dakorduaranë përputhje me standardet e shërbimit që janë përcaktuar në këtë Marrëveshje gjatë një periudhe të vazhdueshme prej 3 muajsh, kjo Marrëveshje do të anulohet automatikisht dhe Komuna nuk do të jetë e obliguar ta paguajë asnjë fakturë të dorëzuar për shërbimet e ofruara gjatë kësaj periudhe.

## 12. Rastet e papritura

Në rast të mosfrimit të shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave që janë përvijuar në këtë Marrëveshjeje apo anulimit të kësaj Marrëveshjeje, Komuna ka të drejtë të shpallë tender për këtë shërbim, në përputhje me rregulloret komunale për prokurim dhe financa, duke marrë këshilla që ajo i konsideron të nevojshme për ta mbrojtur shëndetin publik dhe kushtet mjedisore dhe për ta siguruar vazhdimin e menjëhershëm të ofrimit të një shërbimi cilësor që siguron vlerë për para.



## Shtojca A–Standardet e detajuara të shërbimit

1. Shërbim i mbledhjes, dhe transportimit të mbeturinave konsiston në:
  - a. zbrazen ekontejnerëve me një pajisje teknologjike të përshtatshme (p.sh.kamion për ngjeshje). Ngritja mekanike e kontejnerëve kërkohet veçanërisht në rast të kontejnerëve të komunitetit.
  - b. Mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura në një rreze prej 10 metrave përreth lokacionit të kontejnerëve, pastrim dhe fshirjen e një hapësire prej 30m<sup>2</sup> përreth lokacionit me fshesë të dorës si dhe zvendësimin e kontejnerëve të riparuar në lokacionin e duhur. Kontejnerët duhet të vendosen në mënyrë estetike dhe të drejtë, në një pozitive vertikale dhe me kapak të mbyllur, me kapakë të hapur të kthyer kah trotuari, dhe të kenë rrota funksionale (sipas mundësisë). Edhe shportat dhe thasët e vegjël të amvisërive duhet të mblidhen siç është përcaktuar në PIO.
  - c. Shërbimet përfshijnë edhe dezinfektimin e kontejnerëve të mbeturinave (posaçërisht kontejnerëve të komunitetit) së pakunjë herë në muaj me pluhur gjelqerë që përmban 5% klor apo element tjetër ekuivalent brenda secilit kontejner. Ky dezinfektim duhet të bëhet pasi të largohen mbeturinat nga kontejneri dhe në vende të veçanta.
2. Komunat bashkërendohen me OSh-në për t'i përcaktuar lokacionet e sakta për magazinimin e mbeturinave dhe numrin e kontejnerëve për secilën pikë të zonës të shërbimit duke i përfshirë të gjitha pikat grumbullimit afër tregjeve që gjenden në zonën e shërbimit.
3. OSh-ja realizon Planin Itinerar dhe Operativ (PIO-në, i cili u bashkëngjitet specifikacioneve teknike) dhe çdo ndryshim gjatë afatit të zbatimit të kësaj MSh-je. Ky plan mund të ndryshohet me propozimin e OSh-së dhe në pajtim me Komunën, sipas nevojave për përmirësim të shërbimit dhe menaxhim më të mirë, apo si rezultat i ndryshimeve në infrastrukturë. Në çdo rast, ndryshimet bëhen me kërkesën e njërës palë dhe me aprovimin e Komunës.
4. Oraret vjetore të punës për shërbime përgatit OSh-ja dhe i aprovon Komuna. Këto orare mund t'u nënshtrohen ndryshimeve sa herë që ka nevojë gjatë vitit. Në planin e punës specifikohet saktësisht:
  - a. Orari i punës (plani kohor) për çdo lokacion të kontejnerëve;
  - b. Lloji, numri i tabelave dhe itinerari i automjeteve për mbledhjen e mbeturinave që do të përdoren për këtë shërbim;
  - c. Orari i punës (plani kohor) dhe automjetet që përdoren për shërbime;
  - d. Numri i punëtorëve që do angazhohen në çdo operacion pune.
5. OSh-ja i zbaton oraret e punës me rigorozitet.



6. Përoraret e largimit të mbeturinave që do të dorëzohen për aprovim do të merret parasysh se punët do të kryhen duke u bazuar në PIO-në.
7. Komunaka të drejtë t'i inspektojë lokacionet e kontejnerëve në çdo kohë dhe pas shërbimit ta kontrollojë performancën për shërbimet e lartpërmendura, zbatimin e standardeve të kërkuara, rregullat dhe cilësisë së kërkuar në këtë Marrëveshje dhe vendosë për zbatimin e ndonjë zbritjeje, ndëshkimi apo gjopërpunëne pakryer.
8. Lokacionet e kontejnerëve do të jenë të pastra Prandaj, OSh-jado të kërkojë nga punëtorët që t'i mirëmbajnë dhe te pastrojne këto lokacione atehere kur kërkoet nje gje e tille .
9. Në asnjë rast, kontejnerët e stërmbushur nuk do të lihen ashtue të mos zbrazen për një periudhë prej më shumë se një dite. Në rast se faktorë zbutës janë pengesat që shkaktohen nga faktorë jashtëm, OSh-jae bën të ditur këtë menjëherë dhe merr masa për pastrimin e mbeturinave jo më vonë se 3 orë pas kohës së shërbimit të planifikuar, të saktësuar nëPIO. Përndryshe, OSh-jakonsiderohet përgjegjës dhe mund të shqiptohen ndëshkime.
10. Nga OSh-jamund të kërkoet që t'i mbledhë dhe transportojë mbeturinat e ngurta komunale që hidhen në hapësirat publike brendazonës së kontraktuar, (p.sh. kur prodhuesi i mbeturinave i hedh ato larg vendeve të aprovuara për deponim). Në rast se mbeturinat hidhen vazhdimisht në vende të tjera, ofruesi i shërbimit rishikon PIO-në dhe kërkon aprovim për vendosjen e kontejnerëve shtesë.
11. OSh-jae informon Komunën periodikisht me shkripër të gjitha kontratat private për pastrim që i ka me palët e treta dhe deklaron numrin e automjeteve dhe punëtorëve shtesë për këto shërbime për ta garantuar cilësinë e shërbimit të kërkuar sipas kësaj MSh-je.
12. OSh-jado ta ketë një linjë telefonike funksionale pa pagesë sipas pikës 7.13 si më lart dhe duhet të ofrojë zgjidhje për çështjet e ngritura brenda 24 orëve.
13. Nga OSh-ja kërkoet që tasigurojë disponueshmërinë e numrit të kërkuar të automjeteve dhe pajisjeve.
14. Nga OSh-ja kërkoet që ta sigurojë disponueshmërinë e numrit të kërkuar të punëtorëve dhe vozitësve i cili është përcaktuar nëPIO.
15. OSh-jae zbraza kontejnerët që gjenden në rrugët kryesore para shërbimeve eventuale të pastrimit të rrugëve dhe sigurohet që kontejnerët të jenë të zbraza pas kryerjes së shërbimeve të pastrimit.

16. Nëse gjatë transportimit mbeturinat bien nga automjetet për mbledhjen e mbeturinave, brenda apo jashtë zonës së shërbimit, materialet derdhura pastrohen menjëherë. Përndryshe, përveç mbulimit të shpenzimeve për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të përhapura, OSh-jamund t'u nënshtrohet ndëshkimeve apo gjobave sipas ligjeve dhe vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.
17. Stafi operativ i OSh-së mban veshur uniforma përderisa është në detyrë dhe përdor pajisjet e nevojshme mbrojtëse personale, siç janë dorëzat, këpucët e qëndrueshme me shputë të fortë dhe haketat fluoeshente.
18. Kontejnerët vendosen sipas PIO-së. OSh-jamund ta rrisë numrin e kontejnerëve nëse ka nevojë sipas kërkesave dhe vëllimeve të mbeturinave të ngurta komunale që prezantohen për mbledhje pas marrjes së pëlqimit nga Komuna.
19. Automjetet/pajisjet teknologjike të nevojshme për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave dhe për shërbimet mbështetëse që kërkohen për përmbushjen e kontratës janë:
  - a. Kamionët me shtrat të hapur me dërrasa anësore apo derë të pasme, të pajisura me mbrojtëse gome, me dokumentacion të rregullt për përdorim, të cilët mund të përdoren për mbledhjen e mbeturinave në lagjet e qytetit aponë fshatra duke përdorur thasë;
  - b. Automjetet adekuat për transportim me ngarkim të pasmë, anësor dhe të përparmë për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave me kapacitet adekuat dhe dokumentacion të rregullt për përdorim për ta siguruar përdorimin efikas;
  - c. Të gjitha automjetet/pajisjet duhet të posedojnë dokumenta të rregullta për operim dhe të përdoren sipas të dhënave teknike dhe specifike të automjetit.
20. Komunamund t'i inspektojë automjetet që i përdor OSh-janë çdo kohë për ta vlerësuar gjendjen operative dhe disponueshmërinë e tyre. Automjetet do të inspektohen së paku çdo 6 muaj.
21. Të gjitha automjetet që do të përdoren për shërbime duhet të jenë në mënyrë adekuate operacionale, të pastradhenë rregull, të ngjyrosura me të njëjtën ngjyrë dhe ta mbartin logon apo shenjën e identifikimit të Komunës dhe/ose OSh-së.
22. Automjetet për mbledhjen e mbeturinave duhet të pastrohen dhe dezinfektohen rregullisht sipas marrëveshjes së arritur me Komunën (p.sh. çdo javë).
23. Të gjithë kontejnerët përdorur duhet të mbahen të pastërdhe në gjendje teknike

të mirë. Në rast të dëmtimit, djegies, deformimitdhdëmtimit të rrotavedhekapakëveqë e pengon përdorimin higjienik, estetik dhe teknikgjatë kohëzgjatjes së kontratës, si dhe në rast të mungesës së kontejnerëve, ofruesi i shërbimite mban përgjegjësinë për mbrojtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin ekontejnerëvenë çdo rast apo për çfarëdo arsye. OSh-jae ndërmerr riparimin e të gjitha dëmevedhesigurimine pjesëve rezervë brenda 3 ditëve nga momenti kur vërehet dëmtimi.

24. OSh-jae përdor emrin e saj në korrespondencat e përbashkëta, thirrjet telefonike, shenjat e automjeteve dheemrin e regjistrimit.Për korrespondenca zyrtare përdoret adresa e postës elektronike zyrtare tëOSh-së.

Draft Version

## Shtojca B – Lokacionet e caktuara

Për këtë MSh do të vlejné lokacionet e caktuara në vijim:

- Objekti i ofruesit të shërbimit:
  - [Shëno listën]
- Garazhi dhe lokacionet e mirëmbajtjes së automjeteve:
  - [Shëno listën]
- Pikat e transferit:
  - [Shëno listën]
- Objektet e riciklimit (duke përfshirë objektet e magazinimit dhe ndarjes së mbeturinave):
  - [Shëno listën]
- Lokacionet e deponive:
  - [Shëno listën]